



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 16.07.2018

Dokument parlamentar

R A P O R T

MBI PROPOZIMIN E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK (KPP) PËR NDRYSHIMET NË STRUKTURË DHE ORGANIKË

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në mbledhjet e datës 16 korrik 2018, **në cilësinë e komisionit përgjegjës**, shqyrtoi propozimin e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) për ndryshimet në strukturën dhe organikën e institucionit të pavarur.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur propozimin dhe për të dhënë shpjegime ishte e pranishme, kryetarja e Komisionit të Prokurimit Publik **Znj.Evis Shurdha**, si dhe perfaqesuesja e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë **Znj.Vilma Çausholli**.

Propozimi është paraqitur nga **Komisioni Prokurimit Publik (KPP)** në mbështetje të pikës 2 të nenit 9 dhe pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9584, dt 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” të ndryshuar,

Propozimi gjithashtu është bazuar në VKM nr. 893, dt 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”

Theksojme se me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 47/2017, datë 13.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, u bë e mundur pavarësia ligjore dhe institucionale e Komisionit të Prokurimit Publik nga ekzekutivi, duke u përmbushur kështu një nga angazhimet kryesore të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020, gjithashtu edhe një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet me partneret ndërkombëtarë, në veçanti me Bashkimin Europian dhe Bankën Botërore. Në vijim të ndryshimeve ligjore të sipërpërmendura dhe konkretisht bazuar në nenin 19/6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, tashmë struktura dhe organika, si edhe numri i punonjësve dhe buxheti i Komisionit të Prokurimit Publik

miratohen nga Kuvendi.

Edhe në rezolutën e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2018 kërkohet konkretisht:

Të marrë masa për të depozituar sa më parë në Kuvendin e Shqipërisë propozimin për miratimin e strukturës dhe organikës së Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me ndryshimet e reja ligjore.

Në propozimin e paraqitur kërkohet një shtesë stafi me 6 punonjës duke bërë që në total numri i punonjësve të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) të shkojë **në 36 punonjës nga 30 që është sot.**

Nga një krahasim i bërë ndërmjet organikës së propozuar nga Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) (me 36 punonjës) dhe organikës së mëparshme të miratuar me me Urdhër të Kryeministrit Nr. 60, datë 12.05.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Komisionit të Prokurimit Publik” (me 30 punonjës) vihet re që 6 punonjësit shtesë janë:

2 inspektorë në Drejtorinë e Ankesave

1 specialist IT dhe një specialist për marrëdhëniet me jashtë

1 këshilltar dhe 1 Sekretar i Përgjithshëm

Gjithashtu sektori i shqyrtimit të ankesave ngrihet në nivel drejtorie.

Në fjalën e saj Znj.Shurdha bëri një paraqitje dhe argumentim të kërkesave për shtesat e kërkuara duke u ndalur në mënyrë të veçantë **tek rritja e numrit të inspektorëve për shqyrtimin e ankesave dhe konkretisht shtimi me 2 inspektorë në Drejtorinë e Ankesave si dhe ngritja e sektorit të shqyrtimit të ankesave në nivel drejtorie**, shtesë e cila është e nevojshme duke ju referuar problematikave të shfaqura në respektimin e afateve të ankesave të cilat u theksuan edhe gjatë diskutimit të raportit vjetor për verimtarinë e KPP.

Respektimi i afateve të ankesave vijon të mbetet problem serioz megjithë përmirësimin e bërë gjatë vitit 2017 (nga 28% në 45.3%), ndaj edhe në rezolutën e miratuar nga Kuvendi u kërkuar që KPP të rrisë përpjekjet për shqyrtimin e ankesave brenda afateve ligjore me qëllim shmangien e krijimit të situatave emergjente për autoritetet kontraktore.

Siaps legjislacionit në fuqi, roli i Inspektorit ka një rëndësi të veçantë dhe është një faktor i drejtpërdrejtë në realizimin brenda afateve ligjore të shqyrtimit dhe vendimmarrjes së ankesave të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Rritja e numrit të inspektorëve pranë Komisionit të Prokurimit Publik sjell njëherazi dhe nevojën e krijimit të një Drejtorie duke zëvendësuar Sektorin e Shqyrtimit të Ankesave. Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave, do të jetë e organizuar me një Drejtor dhe 16 inspektorë në varësi direkte të Drejtorit të Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave. Pra, në total kjo drejtori do të ketë 17 punonjës.

Gjithashtu Znj.Shurdha argumentoi edhe kërkesat e tjera të paraqitura në propozimin për ndryshimet në strukturë dhe organikë.

Nga ana e deputetëve u bënë disa pyetje dhe u kërkuan sqarime për të cilat Znj.Shurdha dha përgjigjet dhe shpjegimet përkatëse.

Ndërkohë Kuvendi i Shqipërisë në mbështetje të pikës 2 të nenit 9 të ligjit nr.9584, dt 17.07.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” të ndryshuar, si dhe mbështetur në pikën 31 të VKM nr.893 datë 17.12.2014. “Për miratimin e rregullave të oragnizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, i kishte dërguar shkresë zyrtare Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për marrjen e mendimit lidhur me propozimin e KPP për ndryshimin e strukturës dhe organikës së tij.

Në përgjigjen e dërguar me shkresën nr.4521/3 dt.25.06.2018 Departamenti i Administratës Publike shprehet në parim dakort me ndryshimet e propozuara KPP.

Ndërkohë Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes shkresës 12084/1 datë 02.07.2018 shprehet se struktura e propozuar nga KPP mbart numër punonjësish dhe kosto financiare të shtuara, të paparashikuara në ligjin vjetor të buxhetit, për vitin 2018. Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkon që propozimi të rivlerësohet, pasi numri i punonjësve duhet të jetë brenda numrit total të organik të punonjësve dhe koston financiare të miratuar për vitin 2018, për KPP

Sa më lart, në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, miratoi me shumicë votash propozimin e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) për ndryshimet në strukturën dhe organikën sipas variantit të projekt vendimit bashkëlidhur këtij raporti. Meqenëse struktura e propozuar nga Komisioni Prokurimit Publik (KPP) mbart numër punonjësish dhe kosto financiare të shtuara, të paparashikuara në ligjin vjetor të buxhetit, për vitin 2018, struktura e miratuar do të bëhet efektive me hyrjen në fuqi të buxhetit të vitit 2019.

KRYETARI

Erjon BRAÇE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTVENDIM

Nr. /2018

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK (KPP)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe në nenin 19/6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me propozimin e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP),

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

- I. Struktura e KPP është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
- II. Organika e KPP është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.
- III. Numri i punonjësve është 36.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me 1 janar 2019.
- V. Për vitin 2018 numri i punonjësve do të jetë 30.


Kryetari

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën . .2018

Lidhja nr.1

STRUKTURA E KOMISIONIT TE PROKURIMIT PUBLIK



Lidhja nr.2**ORGANIKA E KOMISIONIT TE PROKURIMIT PUBLIK**

Pozicioni	Kategoria	Numri i punonjësve
Kryetar		1
Sekretar		1
Nenkryetar		1
Anëtar		3
Këshilltar	II-b	1
Sekretar i Përgjithshëm	I-b	1
Drejtor	II-b	1
Inspektor	III-a	16
Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Mbështetëse	III-a	1
Specialist IT	III-b	2
Specialist Finance / Buxheti	III-b	1
Specialist Arkiv / Protokolli	IV-a	1
Specialist/jurist	III-b	2
Specialist	III-b	1
Specialist (për Marrëdhëniet me Jashtë)	III-b	1
Sanitar		1
Shofer		1

Gjithsej 36 punonjës